

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 50, paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.172/14), pika 6 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-4124/1 datë 04.10.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4644/13 datë 18.11.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 42- të mbajtur më 15.11. 2024 miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrjen e masës - paralajmërim publik

PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) Televizioni SITEL SHPKNJP Shkup, për shkëlqen e kryer të nenit 50, paragrafit (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) dhe neneve 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve (RRMPM), të mënyrës që në shërbimin programor televiziv të radiodifuzerit, më 2 shtator 2024, njoftimet dhe episodet të disa serialeve artistike janë transmetuar me aplikim të gabuar të sinjalistikës paralajmëruese për programin e kategorisë së dytë (8+), përkatësisht:

- në njoftimet për programin artistik "Lojëra bashkëshortore (Braçni igri)", "Përadha për Sevdën (Prikaznata za Sevda)" dhe "Vajza nga dritarja (Devojkata od prozorecot)", nga tërësia e pamjes së parashikuar me ligj të aplikimit të sinjalistikës paralajmëruese për programin e klasifikuar në kategorinë e dytë, mungon numri "8" dhe shenja "+", si tregues i grupmoshës së shikuesve për të cilin destinohet programi;

- para fillimit të transmetimit, episodet reprizë/premierave të serialeve artistike "Nektari dhe mjalti Pelin i med)", "I dyshuari (Osomniçen)", "Lojëra bashkëshortore (Braçni igri)", "Përadhë për Sevdën (Prikaznata za Sevda)" dhe "Vajza nga dritarja (Devojkata od prozorecot)", nga tërësia e pamjes së përcaktuar me ligj të aplikimit të sinjalistikës paralajmëruese për program të klasifikuar në kategorinë e dytë, mungonte numri "8"; shenja "+", teksti i shkruar dhe i lexuar i paralajmërimit, si tregues të grupmoshës së shikuesve për të cilin destinohet programi dhe

- Numri "8" dhe shenja "+" mungonin gjithashtu dhe në sinjalizimin e aplikuar vazhdimisht gjatë episodeve të transmetuara.

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4124/1 datë 04.10.2024, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. Urdhërohet SHTR Televizioni SITEL SHPKNJP Shkup në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV dhe RRMPM.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Vendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij konsiderohet dita e çertifikimit në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të radiodifuzerëve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave nga ligji i cituar, lejet, certifikatat e lëshuara të regjistrimit, aktet nënligjore dhe aktet tjera të miratuara nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesit të medias (radiodifuzer) ndërmerr masë - vërejtje publike në pajtim me këtë ligj, në rastet kur ka cënim ose shkelje të dispozitat e LSHMAAV dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij, si dhe kushtet dhe detyrimet e përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 50, paragrafi (1) të LSHMAAV, radiodifuzerët nuk mund të transmetojnë ose transmetojnë programe që mund seriozisht të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor dhe moral të të miturve, në veçanti programe që përmbajnë pornografi ose dhunë të tepruar. Ofruesit e shërbimeve, sipas kërkesës, duhet të ndërmarrin masat teknike më të rrepta për të siguruar që të miturit të mbrohen nga përmbajtja më e dëmshme si dhuna e tepruar dhe pornografia. Përveç programeve nga paragrafi (1) i këtij neni, programe të tjera që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor ose moral të të miturve, sigurohen nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale në mënyrë që të miturit të mos mund t'i shohin në mënyrë të zakonshme ose të dëgjojnë programet. Kur programet transmetohen ose rishikohen në formë jo të koduar, ofruesi i shërbimeve mediatike audiovizuale është i detyruar që përpara transmetimit të tyre të siguron paraprakisht paralajmërim akustik dhe mundësinë që të identifikohet me ndihmën e shenjave vizuale gjatë gjithë transmetimit të programeve (neni 50 paragrafi 3 i LSHMAAV).

Neni 20 i RRMPM parasheh mënyrën e aplikimit të sinjalistikës paralajmëruese. Në pajtim me nenin 1 nga Ligji i njëjtë para fillimit të programeve televizive të përfshirë në nenin 19 të Rregullores (Programet në të cilat aplikohet sinjalizimi paralajmëruar), detyruimisht transmetohet sinjali paralajmëruar që korrespondon me kategorinë e programit që është kombinim i shenjës vizuale, tekstuale, verbale dhe paralajmërim akustik, që zgjat së paku 10 sekonda dhe mbulon së paku 1/4 e pjesës së dukshme të ekranit. Në vazhdimin e programeve televizive të përfshirë në nenin 19 të Rregullores, vazhdimisht transmetohet vetëm shenjë vizuale e sinjalit paralajmëruar, i cili aplikohet me dimensionet nga 1/32 në këndin e pjesës së dukshme të ekranit. Përjashtim janë shenjat vizuale për programet televizive me teknika hipnotizuese dhe me dridhje drite, që aplikohen në ekran pas çdo pauze për reklamim (paragrafi 2).

Në nenin 21 të RRMPM (Pamja dhe përmbajtja e sinjalistikës paralajmëruese), ndër të tjera, është parashikuar që sinjalistika paralajmëruese që aplikohet para, deri ose gjatë programeve nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale, për programet e klasifikuara në kategoria e dytë, duhet të qëndrojë numri "8" dhe shenja "+", si dhe tekstin e paralajmërimit: "Programet e kategorisë së dytë që nuk rekomandohen për fëmijët nën 8 vjeç. I domosdoshëm mbikëqyrja nga prindi ose kujdestari."

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 4 tetor 2024, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR Televizion SITEL SHPKNJP Shkup, transmetuar më 2 shtator 2024, në nivel shtetëror, nga ku është konstatuar shkelje e nenit 50, paragrafi (3) të LSHMAAV dhe neneve 20 dhe 21 të RRMPM.

Përkatësisht, me mbikëqyrjen e rregullt programore mbi shërbimin programor televiziv të SHTR Televizion SITEL SHPKNJP Shkup, transmetuar më 2 shtator 2024, në nivel shtetëror, është konstatuar shkelje e nenit 50, paragrafi (3) të LSHMAAV dhe neneve 20 dhe 21 të RRMPM, të mënyrës që në kundërshtim me nenet 20 dhe 21 të RRMPM, në shërbimin programor të datës 2 shtator 2024, me aplikim të gabuar të sinjalizimit për programin e kategorisë së dytë (8+), janë transmetuar njoftime dhe episode të disa serialeve artistike, përkatësisht:

- në njoftimet për programin artistik "Lojërat bashkëshortore (Braçni igri)", "Përadhë për Sevdën (Prikaznata za Sevda)" dhe "Vajza nga dritarja (Devojkata od prozorecot)", nga tërësia e pamjes së parashikuar me ligj të sinjalistikës paralajmëruese të aplikuar për programin e klasifikuar në kategorinë e dytë, mungon numri "8" dhe shenja "+", si tregues të grupmohës së shikuesve për të cilët synohet programi;

- para fillimit të transmetimit, episodet e përsëritura/premiera të serialeve artistike "Nektari dhe mjalti (Pelina i med)", "I dyshimtë (Osomniçen)", "Lojërat bashkëshortore (Braçni igri)", "Përadhë për Sevdën (Prikazna za Sevda)" dhe "Vajza nga dritarja (Devojkata od prozorecot)", në tërësinë e gjithë pamjes së përcaktuar me ligj të sinjalistikës paralajmëruese të aplikuar për programin e klasifikuar në kategorinë e dytë, mungon: numri "8"; shenja "+", teksti i shkruar dhe që lexohet i paralajmërimit, si tregues të grupmohës së shikuesve për të cilët synohet programi; si dhe

- numri "8" dhe shenja "+" mungojnë gjithashtu në sinjalistikën e aplikuar në vazhdimësi gjatë episodeve të transmetimit.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4124/1 datë 04.10.2024, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR Televizioni SITEL SHPKNJP Shkup, më 08.10.2024 dërgoi Shkresë me nr ynë.ark.10- 4124/2 datë 08.10.2024, me të cilin ka dorëzuar Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore, ark.nr. 10-4124/1 datë 04.10.2024, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaram me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV dhe RRMPM. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 09.10.2024, për të cilën në afatin e parashikuar SHTR Televizioni SITEL SHPKNJP Shkup nuk ka dorëzuar deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV dhe RRMPM. Këshilli i Agjencisë, në seancën e 42-të mbajtur më 15.11.2024, e shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe deklaratën e dorëzuar me shkrim dhe konstatoi që SHTR Televizioni SITEL SHPKNJP Shkup t'i shqiptohet masë – vërejtje publike .

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 50, paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë dhe neneve 20 dhe 21 të RRMPM, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarjen e masës (Tekst i pastruar), Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-4124/1 datë 04.10.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-4644/13 datë 18.11.2024, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV dhe RRMPM, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë së seancën e 42-të mbajtur në 15.11.2024, miratoi Aktvendimin me të cilin publikisht paralajmëron SHTR Televizion SITEL SHPKNJP Shkup dhe urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV dhe RRMPM. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit..

Bazuar nga sa mësipër u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-4124/1 datë 04.10.2024.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit e aktvendimit.